

NJOFTIM
Nr. 8274, datë 23.6.2025

PËR SHITJE ME ANKAND TË PRONËS SHTETËRORE NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË ADMINISTRIMIT TË PASURIVE TË SEKUESTRUARA DHE TË KONFISKUARA

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 888, datë 11.11.2020, “Për përcaktimin e kriterëve të vlerësimit, mënyrat dhe procedurat e dhënies në përdorim dhe të tjetërsimit të pasurive të konfiskuara”, dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 926, datë 29.12.2014, “Për kriteret e vlerësimit të pronës shtetërore, që privatizohet apo transformohet dhe për procedurën e shitjes”, kapitulli III, shpallet për shitje me çmim fillestar, si më poshtë:

Në administrim të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara

Nr.	Emërtimi	Viti i prodhimit	Vlera fillestare e ankandit në lekë	Zhvillimi i ankandit		
				Data	Ora	Vendi
1	Porsche Panamera	2010	100 000	22.7.2025	10:00	DSHPP

Çdo person fizik apo juridik i interesuar për blerje me ankand duhet të paraqesë në vendin, datën dhe orën e njoftuar pranë komisionit të ankandit, dokumentacionin si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për blerjen e objektit, apo të ndërmarrjes, e regjistruar pranë protokollit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.

2. Mandatpagesën apo garancinë bankare në origjinal, që vërteton derdhjen apo ngurtësimin e 20% të vlerës së fillimit të ankandit, në lekë, për llogari të Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara.

3. Deklarimin personal të secilit pjesëmarrës, që vërteton se ky i fundit nuk është në konflikt interesi, sipas dispozitave të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009, të ndryshuar dhe të ligjit nr. 34/2019, të ndryshuar.

4. Dokument identifikimi (pasaportë biometrike ose letërnjoftim).

Shënim. Pjesëmarrësit në ankand, i cili tërhiqet nga ankandi pa dhënë asnjë ofertë për vlerën e objektit të shpallur për shitje, nuk i kthehet 20% e vlerës fillestare, të ngurtësuar për pjesëmarrje në ankand.

Mandatpagesa apo garancia bankare duhet të bëhet detyrimsht brenda afatit të pranimit të kërkesave për pjesëmarrje në ankand. Mandatpagesa apo garancia bankare mund të bëhen pranë çdo banke të nivelit të dytë në llogaritë respektive të hapura për Agjencinë e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pasi të kenë tërhequr pranë kësaj agjencie faturën për arkëtim të plotësuar dhe të nënshkruar nga përfaqësuesi i institucionit.

Këto informacione gjenden edhe në faqen e internetit të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit: www.meki.gov.al.